

Nr. 2505/043 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 06/05/2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: **DENONCIM Nr. 29** – Lidhur me shpërdorimin e burimeve publike nëpërmjet komunikimit periodik "Sy m'sy" të Kryeministrit, SHTZ. Edi Rama, për qëllime elektorale në përfitim të Subjektit Zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

I nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!

Në periudhën përpara Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, duke nisur nga data 20 shkurt 2025, Kryeministri i Shqipërisë, SH.T.Z. Edi Rama nisi një komunikim të drejtpërdrejtë javor në platformën e mediave sociale Facebook, të titulluar "Sy m'sy". Këto sesione organizohen nga zyra e Kryeministrit gjatë orarit zyrtar të punës. Në to Kryeministri diskuton arritjet e qeverisë dhe trajton tema të lidhura ngushtë me fushatën zgjedhore që është duke u zhvilluar.

Në gjykimin e KRIIK, **këto sesione komunikimi konsiderohen si një përdorim i papërshtatshëm i burimeve shtetërore dhe i funksionit publik nga ana e Kryeministrit të Shqipërisë për avantazh elektorale**, duke u fokusuar veçanërisht në potencialin e platformës për t'i siguruar Kryeministrit një avantazh ndaj kandidatëve të tjerë në zgjedhje dhe Subjektit Zgjedhor "Partia Socialiste" që ai drejton.

Sesionet e komunikimit të Kryeministrit "Sy m'sy" janë një veçori e rregullt e periudhës parazgjedhore, thuajse të gjitha mediat e raportojnë rregullisht për zhvillimin e tyre, **ndërkohë që një numër i konsiderueshëm i tyre i transmetojnë ato drejtpërdrejt.** (për më shumë shih Lidhjen nr. 1)

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Këto transmetime të drejtpërdrejta zhvillohen nëpërmjet faqes personale të Facebook-ut të Kryeministrit Edi Rama, të cilat bëhen share në mënyrë masive në platformën e facebook-ut duke arritur kështu një numër jashtëzakonisht të madh përdoruesish. Format i përfshin Kryeministrin duke iu drejtuar drejtpërdrejt audiencës dhe duke u angazhuar me komentet e postuara nga shikuesit.

Përmbajtja e këtyre sesioneve është e larmishme, duke filluar **nga kërkimi i drejtëpërdrejtë i votës për Partinë Socialiste dhe fyrjen deri në shkallë intimidimi të atyre që nuk e votojnë atë**¹, e më pas tek diskutimet mbi arritjet aktuale të qeverisë apo të tjera tema. Megjithatë, vlen të theksohet se prezantimi i arritjeve qeveritare në kontekstin zgjedhor **nuk mund të shihet thjesht si një informim neutral i publikut**.

Përkundrazi, ato janë të ndërthurura strategjikisht me mesazhe që nënkuptojnë ose shprehimisht promovojnë fushatën e Partisë Socialiste për rizgjedhje².

Për shembull, Kryeministri shpesh i paraqet këto arritje si dëshmi të lidhshëm të vet dhe suksesit të politikave të Partisë Socialiste³ duke sugjeruar se mbështetja e vazhdueshme në zgjedhjet e ardhshme është e nevojshme për të ruajtur këtë trajektore pozitive⁴.

Temat e lidhura me fushatën janë një veçori e rregullt e këtyre komunikimeve, me Kryeministrin që shpesh diskuton perspektivën e Partisë Socialiste në lidhje me drejtimin e vendit në katër vitet e ardhshme, pas Zgjedhjeve të 11 majit⁵. Gjithashtu, ai ka shprehur besim të fortë në sigurimin e një shumice tjetër qeverisëse në zgjedhjet e 11 majit⁶.

¹ [Sesioni i “Sy m’sy”, datë 6 maj 2025](#) duke iu drejtuar shqiptarëve që jetojnë jashtë: min. 03:38 “... hapeni zarfin, vini shënimin tek numri 5 dhe dërgoheni mbrapa. ...”.

Me pas duke iu drejtuar të gjithë qytetarëve që e ndjekin: min. 25:45:

“... Edhe **me mend në kokë, në datën 11** takimi me historinë kërkon që të mbidhemi **të gjithë tek pesa, tek numri 5, te Partia Socialiste**. Kush nuk e bën dot këtë kapërcim atëherë **le të mos ta vërë tek 5 shënimin, le ta vërë tek një nga kandidatët e listës preferenciale, një votë aty**. Se ia kemi dhënë të gjitha qarqeve grupet, skuadrat, mundësitë. I duan të djathtë, ia duan të majtë, i duan gra, i duan burra, i duan vajza, i duan djem, i duan nga zona e tyre, i duan nga zona pranë, i duan nga ..., si t’i duan. I kanë të gjitha zgjedhjet aty. Dhe **nëse pastaj as këtë nuk e bëjnë dot, mos të shkojnë në kënetë, të rrijnë në shtëpi. ...**”.

² [Sesioni i “Sy m’sy” i datës 29 prill](#), min. 07:09: “Dhe mundësia për të bërë histori tanimë na ka ardhur në dorë, është në dorën tonë, në 11 maj. Duke u bërë më shumë sesa një shumicë e thjeshtë aritmetike për të shtyrë më fort procesin e negociatave në Bashkimin Europian dhe për t’i mbyllur ato brenda vitit 2027.”

³ [Sesioni i “Sy m’sy”, datë 1 maj 2025](#): Min. 14:10: “Jam krenar që kemi bërë pune dhe që kemi bërë vepra aq të mëdha dhe aq të mira sa që sot Shqipëria e ka prodhimin e përgjithshëm kombëtar dy herë e gjysmë më të lartë se ç’e kishte. Pra kishte një prodhim të përgjithshëm kombëtar më pak se 10 miliardë euro, gjithë vlera e krijuar në këtë vend ishte më pak se 10 miliardë euro dhe sot e ka 25 miliardë euro, dhe projekcioni për Shqipërinë 2030 është 35 miliardë euro. Ky është fakt, nuk është opinion. Kjo është Shqipëria sot krahasimisht me Shqipërinë **kur ne morëm detyrën**. Dhe këto nuk janë as llafe, as 3d, as fushata, as mitingje. Këto janë të vërteta shumë kokëforta të transformimit ekonomik të këtij vendit.”

Po aty, min. 17:19: “...Ç’kemi bërë 12 vite? Këto jam duke treguar, urdhëro dhe të ardhurat për frymë. Këto janë të ardhurat për frymë, ç’a kemi bo në këto 12 vite. Ishin 3.300 euro, janë 10.300 euro dhe në Shqipërinë 2030 do shkojnë 15.000 euro. Dhe këto që flasim ne për Shqipërinë 2030 **nuk janë si programi i bufit dhe i Latifit**. Këto janë analiza të bazuara në analizat e ekspertëve të Ministrisë së Financave, të ekspertëve ndërkombëtarë me të cilët ne punojmë [...]. Kështu që këto janë projeksione financiare, nuk janë përralla me mbret, as përralla me buf, as përralla me Latif.”

⁴ [Sesioni i “Sy m’sy” i datës 29 prill](#), min. 46:02: “Është e drejta juaj, jemi në demokraci, secili bën zgjedhjen e vet, askujt nuk i ndalohej të bëjë zgjedhjen e gabuar. E merr vetë pastaj edhe përgjegjësinë, **edhe shijen e hidhur të humbjes që, fatkeqësisht po s’më dëgjuat, do ndjeni në 11 maj**.”

⁵ [Sesioni i “Sy m’sy”, datë 1 maj 2025](#): min. 09:14: “... programi ynë është program qeverisës, është i detajuar në çdo aspekt. Ne nuk jemi **një parti politike që duam të vijmë në qeveri**, që nuk dimë fare se ç’është qeverisja, që s’kemi qenë ndonjëherë, kurrë brenda në mekanizmin e shtetit edhe imagjinojmë se si mund të bëhet dhe shtojmë dozat nga dëshira që të bëjmë këtë gjë të duket fushë me lule. Në jemi forcë qeverisëse. **Ne kemi, pa diskutim, programin tonë dhe kemi programin më të qartë dhe më bindës dhe më të besueshëm**.”

[Sesioni i “Sy m’sy” i datës 29 prill](#), min. 5:05: “... jemi afër finishit por nuk jemi në finish. **Sprinti drejt finishit është mandati i katërt për të anëtarësuar Shqipërinë në Bashkimin Europian**.”

⁶ [Sesioni i “Sy m’sy” i datës 29 prill](#), min. 13:08 “Dhe një nga arsytet pse **Partia Socialiste do të marrë rezultatin më të mirë që ka marrë ndonjëherë nën drejtimin tim** është fakti se për herë të parë populli shqiptar po shikon një përpjekje serioze për të vendosur barazinë para ligjit.”

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Për më tepër, Kryeministri përdor platformën "Sy m'sy" për t'iu përgjigjur komenteve dhe akuzave të drejtuara ndaj tij dhe administratës, duke e përdorur atë si një mundësi për të mbrojtur arritjet e qeverisë dhe për të kundërshtuar narrativat potencialisht të dëmshme. **Partitë opozitare janë vazhdimisht një objektiv kritikash dhe sulmesh gjatë këtyre sesioneve, një qasje qartësisht me synim elektoral⁷.**

Një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjes i kushtohet promovimit të programit "Shqipëria 2030", i cili shërben si një vizion afatgjatë i qeverisjes.

Ky vizion afatgjatë për zhvillimin e vendit, ndërsa prezantohet si një iniciativë qeveritare, përbën gjithashtu një shtyllë qendrore të platformës elektorale të Partisë Socialiste. Duke i kushtuar kohë të konsiderueshme gjatë këtyre sesioneve për të paraqitur qëllimet dhe përfitimet e "Shqipëria 2030", Kryeministri në fakt po **bën fushatë për axhendën e Partisë Socialiste nën maskën e komunikimit zyrtar qeveritar**. Rëndësia e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian është një tjetër temë e përsëritur, shpesh e paraqitur si një çështje kritike për të ardhmen e vendit dhe e lidhur me rëndësinë e zgjedhjeve të ardhshme.

Planifikimi i vazhdueshëm javor dhe formati i drejtpërdrejtë në një platformë të mediave sociale si Facebook sugjerojnë një përpjekje të llogaritur dhe të vazhdueshme për t'u angazhuar me elektoratin shqiptar në periudhën vendimtare para zgjedhjeve parlamentare.

Ndërsa në dukje rubrika "Sy m'sy" ofron një platformë për komunikim të drejtpërdrejtë dhe transparencë, **përdorimi i faqes personale të Facebook-ut të Kryeministrit, potencialisht zbeh dallimin mes rolit të tij si Kreu i Qeverisë dhe rolit si Kryetar i Partisë Socialiste**, i cili është i angazhuar në mënyrë aktive në një fushatë për t'u rizgjedhur.

Ndërsa sesionet "Sy m'sy" mund të përfshijnë diskutime mbi arritjet qeveritare, nisja e tyre në periudhën parazgjedhore, e shoqëruar me përfshirjen strategjike të mesazheve të fushatës dhe kritikave ndaj kundërshtarëve politikë, sugjeron se **një objektiv kryesor i këtyre sesioneve është të sigurojë avantazh elektoral për Kryeministrin dhe Partinë Socialiste**. Prezantimi i sukseseve qeveritare pak para zgjedhjeve është një taktikë e mirënjohur për të ngarkuarit që kërkojnë të forcojnë imazhin e tyre dhe të bindin votuesit të ruajnë status quo-në.

Sulmet e vazhdueshme ndaj opozitës forcojnë më tej natyrën partizane të platformës dhe rolin e saj në strategjinë më të gjerë elektorale.

⁷ P.sh. [Sesioni i "Sy m'sy" i datës 29 prill](#) ishte i dedikuar për kontratën e lobimit të Partisë Demokratike dhe u përdor vetëm për të sulmuar opozitën. Ndërkohë, në [Sesionin e datës 1 maj](#) në min. 11:36: "...ky është opinionimi yt, një opinion personal, **i nxjerrë nga uji i kënetës me të cilin t'i shuan etjen**, se kjo është shumë e qartë, por gjithsesi është opinionimi yt. Ama ka një gjë Subi, populli është më i mençur se unë dhe se ti. Populli di vetë se çfarë gjykon, se si gjykon dhe si vendos. Dhe siç mund ta shohësh nga të gjitha sondazhet Subi, shumica e popullit mendon ndryshe nga ti, dhe **mendon shumë ndryshe nga kënetat ku, për fat të keq ti ushqehesh politikisht**".

[Sesioni i "Sy m'sy", datë 1 maj 2025](#), min. 18:50 "Kandidati më i ri dhe më i vjetër këtu jam unë. Në kuptimin e energjisë dhe eksperiencës. Dhe **partia më e re dhe më e vjetër është Partia Socialiste. Dhe në listat e Partisë Socialiste, në çdo qark gjen më të rinjtë, gjen edhe ata më me eksperiencë**. Kështu që, kjo teoria duhet një kandidat i ri, pa parti mbrapa, pa struktura, pa ekspertizë, pa asgjë, vetëm bla bla bla, **imitacione të një partie që ishte ndjesë pastë deri dje e treta e vërteta dhe u bë barra dhe halli i madh i politikës shqiptare, nuk ka nevojë Shqipëria**. Nuk ka nevojë faqe Shqipëria për këto të tretat të vërtetat që në fakt janë vetëm shëmbëlltyra që kërkojnë të hyjnë në valle dhe pastaj të bëhen grabitqare."

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Sesionet "Sy m'sy" organizohen nga zyra e Kryeministrit brenda Kryeministrisë dhe zhvillohen gjatë orarit zyrtar të punës.

Ky aktivitet **nëse do të konsiderohej veprimtari publike**, sikurse është komunikimi me publikun për të informuar mbi arritjet e politikave të qeverisë, **duhet të ishte raportuar si e tillë prej Stafit të Kryeministrisë, çka në fakt nuk rezultoi kështu.**

Fakti që sesionet organizohen nga zyra e Kryeministrit nënkupton gjithashtu **përfshirjen e punonjësve të administratës publike në planifikimin, koordinimin dhe potencialisht ekzekutimin teknik të transmetimit të tyre.** Për më tepër, përdorimi i zyrës së Kryeministrit si vend nënkupton në mënyrë të natyrshme se po **përdoren burime në pronësi të qeverisë.** Kjo përfshin **hapësirën fizike, lidhjen e internetit si dhe pajisjet teknike** që duhen për të realizuar sesionet.

Zhvillimi i atyre që në thelb janë **komunikime të ngarkuara politikisht, të cilat vazhdimisht prekin tema elektorale dhe promovojnë Kryeministrin, qeverinë, dhe Partinë Socialiste,** nga zyra e Kryeministrit gjatë orarit të rregullt të punës **tregon një përdorim të drejtpërdrejtë të burimeve shtetërore për avantazh elektoral.**

Zyra e Kryeministrit dhe orari i punës i nëpunësve civilë financohen nga fondet publike dhe synojnë kryerjen e detyrave qeveritare në shërbim të të gjithë popullatës, **jo për aktivitete që synojnë kryesisht promovimin e perspektivave elektorale të një partie të caktuar politike.**

Përfshirja e stafit të zyrës së Kryeministrit në organizimin dhe ekzekutimin e "Sy m'sy" **përfaqëson një devijim të burimeve publike, veçanërisht kohës së tyre, drejt një aktiviteti që ka një dimension të qartë elektoral.**

Përtej përdorimit të infrastrukturës dhe burimeve fizike, përmendur më sipër, ajo **çka është më shqetësuese është se platforma "Sy m'sy" ofron një kanal të drejtpërdrejtë për qytetarët shqiptarë që të angazhohen me Kryeministrin, një nivel akses që zakonisht nuk është i disponueshëm për kandidatët e tjerë që garojnë për post në zgjedhjet e 11 majit 2025.**

Qytetarët në këtë rast ndërveprojnë me z. Rama në cilësinë e tij si Kryeministër **dhe jo si Kryetar i Partisë Socialiste.** Ky dallim është parësor sepse **i jep një nivel të konsiderueshëm autoriteti dhe besueshmërie deklaratave të tij** që nuk do të lidheshin domosdoshmërisht me një komunikimin nga një lider partie.

Sa më sipër **i siguron Kryeministrit një avantazh të konsiderueshëm në aspektin e legjitimitetit të perceptuar dhe besimit publik në krahasim me garuesit e tjerë elektorale që nuk e posedojnë platformën e ofiqit zyrtar,** një prej tre më të lartëve në hierarkinë e shtetit shqiptar.

Si rrjedhojë, gjykohet se sesionet "Sy m'sy" **krijojnë qartazi pabarazi në garën elektorale në prag të zgjedhjeve.** Duke shfrytëzuar platformën dhe burimet e tij zyrtare për komunikim të drejtpërdrejtë dhe të rregullt me publikun, **Kryeministri fiton një avantazh unik dhe të konsiderueshëm në aspektin e dukshmërisë dhe angazhimit që nuk është i disponueshëm në mënyrë të barabartë për kandidatët e tjerë.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9 i Komisionit Rregullator **ndalon shprehimisht përdorimin e burimeve shtetërore për të mbështetur kandidatë ose parti të caktuara në zgjedhje.**

Duke qenë se "Sy m'sy" zhvillohet nga zyra zyrtare e Kryeministrit gjatë orarit të punës dhe përmban përmbajtje që promovon udhëheqësin aktual dhe partinë e tij duke kritikuar kundërshtarët, në gjykimin e KRIIK i bën këto sesione komunikimi të jenë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor.

KRIIK vlerëson se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të marrë në konsideratë e shqyrtojë me vëmendje këtë shkelje të vazhdueshme, si dhe të ndërmarrë hapat proceduralë të nevojshëm për të marrë masat administrative të parashikuara nga Kodi Zgjedhor për Kryeministrin, stafin e tij, si dhe Subjektin Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” si pëfituese e kësaj shkeljeje, bazuar në nenet 171 dhe 172 të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

***Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)***

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

LIDHJA NR. 1.

Printscreen-e të rubrikës “Sy m’sy” në facebook si dhe të transmetimit të saj LIVE në disa media audio-vizive.



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania